REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Akademia e Sigurisë

Nr.932/3 Prot. Tiranë, më 16.7.2026

THIRRJE PËR PJESËMARRJE

NË KONFERENCËN XII SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

'INTEGRIMI I DIMENSIONIT TEORIK ME PRAKTIKËN OPERACIONALE NË FUNKSION TË HETIMIT DHE LUFTËS KUNDËR KRIMIT"

TË AKADEMISË SË SIGURISË

TIRANË, 12 NËNTOR 2026

Akademia e Sigurisë (AS) njofton zhvillimin e konferencës së saj XII shkencore ndërkombëtare, më 12 nëntor 2026, me temë: **"Integrimi i dimensionit teorik me praktikën operacionale në funksion të hetimit dhe luftës kundër krimit".**

AS, në bashkëpunim me universitete vendase, universitete italiane dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë, si dhe në kuadër të shoqatës Rajonale të Akademive Policore të Europës Juglindore RAPATC SEE, ka kënaqësinë të shpallë thirrjen për paraqitjen e punimeve shkencore në kuadër të konferencës XII shkencore vjetore, e cila do të zhvillohet më 12 nëntor.

Konferenca synon të krijojë një platformë të qëndrueshme akademike dhe profesionale për shkëmbimin e ideve, prezantimin e kërkimeve shkencore dhe diskutimin e praktikave më të mira në fushën e sigurisë, hetimit dhe zbatimit të ligjit. Në fokus do të jetë forcimi i lidhjes ndërmjet kërkimit shkencor, arsimit të lartë dhe praktikës operacionale, në përputhje me standardet evropiane të edukimit dhe nevojat bashkëkohore të institucioneve të sigurisë.

Scanned with CamScanner

TEMATIKA E MUNDSHME ORIENTUESE

Punimet mund të trajtojnë, por pa u kufizuar, në temat e mëposhtme:

1. reforma dhe zhvillimi i kurrikulave;
2. hetimet proaktive;
3. hetimet financiare;
4. inteligjenca kriminale;
5. siguria kibernetike;
6. përdorimi i teknologjive të avancuara në procesin hetimor;
7. bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit;
8. çështje të tjera që lidhen me zhvillimin e arsimit, kërkimit dhe praktikës profesionale në fushën e sigurisë.

TIPI I KONFERENCËS

Konferencë shkencore ndërkombëtare, me audiencë të gjerë nga akademia, praktika policore, sektori privat dhe organizatat ndërkombëtare. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të prezantojnë punime shkencore, të diskutojnë praktika dhe të krijojnë ura bashkëpunimi për projekte të ardhshme.

PJESËMARRËSIT

Konferenca është e hapur për:

- stafin akademik të Akademisë së Sigurisë;
- ekspertë e studiues nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit;
- akademikë nga institucionet publike dhe private të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit;
- studiues dhe ekspertë të fushës së sigurisë, të inteligjencës artificiale, të teknologjisë dhe hetimit nga vendet partnere, si dhe nga vendet anëtare të RAPATC SEE
- përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë dhe qendrave kërkimore.

Të gjitha punimet do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit shkencor (*peer review*), sipas standardeve të konferencës. Punimet e pranuara do të prezantohen gjatë sesioneve dhe do të përfshihen në botimin e librit (*Proceedings)* zyrtar të konferencës.

DATA TË RËNDËSISHME

Data e konferencës: 12 nëntor 2026.

30 shtator 2026: Afati i fundit i dorëzimit të punimeve të plota (pas konfirmimit).
Punimet dërgohen në adresën: **kerkimishkencor.as@gmail.com**

Scanned with CamScanner

Të gjithë bashkëpuntorët e pjesëmarrësit në kuadër të RAPATC SEE janë të lutur ti dërgojnë punimet e tyre edhe në adresën **albert.mullai@asp.gov.al**

DORËZIMI I PUNIMEVE

Punimet duhet të jenë origjinale, të papublikuara më parë dhe të përgatiten sipas udhëzuesit të Akademisë së Sigurisë. Informacioni mbi formatin teknik, kriteret e hartimit dhe mënyrën e dorëzimit do të publikohet së bashku me udhëzimet për autorët.

FOKUSI I KONFERENCËS

Konferenca do të fokusohet në forcimin e lidhjes ndërmjet kërkimit shkencor, arsimit të lartë dhe praktikës operacionale në fushën e sigurisë dhe zbatimit të ligjit. Në qendër të diskutimeve do të jetë integrimi i dimensionit teorik me nevojat reale të institucioneve të sigurisë, me synim zhvillimin e modeleve bashkëkohore të edukimit, hetimit dhe menaxhimit të sfidave të kriminalitetit. Një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet zhvillimeve të reja në hetimin penal, inteligjencën kriminale, sigurinë kibernetike, hetimet financiare dhe përdorimin e teknologjive të avancuara në procesin hetimor. Konferenca do të shërbejë si forum për shkëmbimin e përvojave ndërmjet akademikëve, studiuesve dhe profesionistëve të institucioneve të zbatimit të ligjit, duke promovuar zgjidhje inovative dhe praktika të bazuara në evidencë shkencore.

OBJEKTI DHE QËLLIMI

Objekti i konferencës është trajtimi shkencor i çështjeve që lidhen me zhvillimin e arsimit në fushën e sigurisë, përmirësimin e praktikës profesionale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional e ndërkombëtar në luftën kundër krimit. Punimet shkencore do të synojnë analizimin e sfidave aktuale, identifikimin e praktikave më të mira dhe formulimin e rekomandimeve konkrete për institucionet akademike dhe ato të zbatimit të ligjit. Qëllimi kryesor i konferencës është krijimi i një platforme të qëndrueshme shkencore për prezantimin e rezultateve të kërkimit, nxitjen e debatit akademik dhe shkëmbimin e përvojave profesionale. Njëkohësisht, konferenca synon të kontribuojë në përmirësimin e programeve studimore, rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, zgjerimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe harmonizimin e arsimit në fushën e sigurisë me standardet evropiane.

SYNIMI I KONFERENCËS

Konferenca synon të prodhojë rezultate konkrete shkencore dhe profesionale, të cilat do t'u shërbejnë institucioneve akademike dhe strukturave të zbatimit të ligjit në përmirësimin e politikave, programeve të studimit dhe praktikave operacionale. Përmes prezantimit dhe diskutimit të punimeve shkencore, pritet të nxiten qasje të reja metodologjike dhe zgjidhje inovative për përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë.

Scanned with CamScanner

Një synim tjetër i rëndësishëm është forcimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërmjet universiteteve, qendrave kërkimore dhe institucioneve të sigurisë, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Punimet e pranuara do të botohen në publikimin zyrtar të konferencës (*Proceedings*), duke kontribuar në pasurimin e literaturës shkencore dhe rritjen e impaktit akademik të kërkimit në këtë fushë.

STRUKTURA E KONFERENCËS

Konferenca do të organizohet në *një seancë plenare* dhe *katër sesione tematike*, të ndërtuara mbi nënfushat kryesore të konferencës. Çdo sesion do të përfshijë prezantime shkencore, diskutime akademike dhe shkëmbim përvojash ndërmjet studiuesve, pedagogëve dhe ekspertëve të praktikës.

Sesioni I – Bashkëveprimi ndërmjet arsimit akademik dhe praktikës profesionale në funksion të hetimit penal.

Ky sesion do të fokusohet në analizimin e marrëdhënies ndërmjet arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe praktikës profesionale të institucioneve të zbatimit të ligjit. Punimet do të trajtojnë mënyrat se si programet akademike, kurrikulat dhe rezultatet e kërkimit mund të kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të hetuesve dhe strukturave të sigurisë, duke garantuar një formim të bazuar në nevojat reale të praktikës.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet modeleve të bashkëpunimit ndërmjet universiteteve, akademive të policisë, prokurorive dhe institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit, me qëllim krijimin e një sistemi të integruar ku teoria, praktika profesionale dhe inovacioni shkencor të mbështesin njëri-tjetrin. Gjithashtu, do të diskutohen përvojat kombëtare dhe ndërkombëtare mbi harmonizimin e arsimit në fushën e sigurisë me standardet evropiane dhe kërkesat e tregut të punës.

Sesioni II – Transferimi i njohurive shkencore në praktikën e hetimit dhe zbatimit të ligjit.

Ky sesion do të trajtojë mekanizmat për shndërrimin e rezultateve të kërkimit shkencor në instrumente konkrete për përmirësimin e veprimtarisë hetimore dhe proceseve të zbatimit të ligjit. Në qendër të diskutimeve do të jenë përdorimi i metodave bashkëkohore të kërkimit, aplikimi i teknologjive të avancuara, zhvillimi i praktikave të bazuara në evidencë dhe ndikimi i inovacionit shkencor në rritjen e efektivitetit të hetimeve.

Punimet do të analizojnë gjithashtu mënyrat për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit akademik dhe institucioneve operacionale, me synim krijimin e një kulture të vazhdueshme të transferimit të njohurive dhe përmirësimit profesional. Përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira, sesioni synon të identifikojë modele efektive për integrimin e kërkimit shkencor në proceset vendimmarrëse, trajnimet profesionale dhe zhvillimin e politikave publike në fushën e sigurisë dhe luftës kundër krimit.

Sesioni III – Arsimi, kërkimi shkencor dhe zhvillimi i kurrikulave.

Scanned with CamScanner

Ky sesion do të trajtojë reformimin e programeve të studimit, zhvillimin e kurrikulave, metodologjitë e mësimdhënies, kërkimin shkencor të aplikuar dhe harmonizimin e arsimit në fushën e sigurisë me standardet evropiane.

Sesioni II – hetimi bashkëkohor dhe inteligjenca kriminale.

Ky sesion do të fokusohet në hetimet proaktive, hetimet financiare, inteligjencën kriminale, përdorimin e teknologjive të avancuara dhe metodave moderne në zbulimin, parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit.

PËRFITIME PËR PJESËMARRËSIT

Publikim i punimeve të përzgjedhura në buletinin shkencor të Akademisë së Sigurisë.
Mundësi për bashkëpunime kërkimore ndërkombëtare.
Krijim lidhjesh (*networking*) me ekspertë dhe kompani teknologjike.

Ju ftojmë të kontribuoni me kërkimet dhe përvojën tuaj shkencore në këtë aktivitet akademik, i cili synon të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, të nxisë inovacionin në fushën e sigurisë dhe të promovojë zhvillimin e praktikave bashkëkohore në hetimin dhe luftën kundër krimit.

Rektori i Akademisë së Sigurisë
Prof. Dr. Ilirjan Mandro

Konc. _ Albert Hoxhaj